REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

Nr.2806/Prot
/16

Pogradec, më 29 . 07 .2025

**VENDIM**

**Nr. 72, datë 28 .07 .2025**

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË BASHKISË POGRADEC"**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma "b", nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Qendrës Arsimore, Bashkia Pogradec, me propozim të kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**
**VENDOSI:**

1. Të miratojë planin e arsimit parauniversitar të bashkisë Pogradec, bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi në shumën 30,157,208.61 (tridhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetë pikë gjashtëdhjetë e një) lekë për rikonstruksionin e kopshtit Liri Çomo dhe ndërtimin e godinës së çerdhes si dhe 70,156,980.43 (shtatëdhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë pikë dyzet e tre) lekë për rikonstruksionin e shkollës "Kajo Karafili", do të përballohen nga fondi i MAS dhe buxheti i Bashkisë Pogradec.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Qendrës Arsimore dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, Bashkia Pogradec.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**KRYETARE E KËSHILLIT**
**Manjola KAMOLLI**

**1.Miratuar me** 18 **vota**
**2.Vota Pro** 18
**3.Vota Kundër** 0
**4.Vota Abstenim** 0
**5.Zbardhur më date** 29.07.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

# Bashkia Pogradec

## Plani i Arsimit Parauniversitar

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA POGRADEC

Përmbajtja


1. Hyrje dhe konteksti ........ 3
1.1 Profili demografik dhe social i Bashkisë: ........ 3
1.2 Përmbledhje e politikave dhe kuadrit ligjor: ........ 4
2. Përmbledhje Ekzekutive ........ 5
Misioni dhe vizioni ........ 5
Qëllimi ........ 5
Synimet e përgjithshme të Planit të Arsimit Parauniversitar ........ 5
3. Analiza e shërbimit të Arsimit Parauniversitar ........ 6
3.1 Analiza e struktures (organika) ........ 6
3.2 Situacioni infrastrukturor ........ 6
3.3 Situacioni Mësimor ........ 7
3.4 Të dhëna për IA,nxënësit, mësuesit dhe drejtuesit në arsimin publik ........ 8
3.5 Të dhëna për IA,nxënësit, mësuesit dhe drejtuesit në arsimin privat ........ 8
3.6 Të dhëna për IA,nxënësit, mësuesit dhe drejtuesit në arsimin profesional ........ 8
3.7 Të dhëna për nxënësit romë dhe egjiptianë në APSH, Arsimin bazë dhe të mesëm ........ 9
3.8 Shërbimi Psiko-Social dhe Nxënësit me Aftësi Ndryshe ........ 9
4. Objektivat dhe planet e veprimtarive te realizimit te tyre ........ 10
4.1 Objektivat ........ 10
4.2 Masat strategjike (Plani i veprimtarive) ........ 11
5. Veprimtaritë vëzhguese (monitoruese) për realizimin e planit vjetor ........ 20
5.1 Vëzhgimi dhe raportimi për zhvillimin e veprimtarive nga grupi i punës ........ 22
5.2 Raportimi i planit vjetor të qëndrës arsimore bashkia pogradec ........ 22
5.3 Detajimi i përafërt financiar për planin vjetor të shkollës ........ 23
5.4 Produkti (treguesit e arritjeve) ........ 24
5.5 Fazat qe kaloi hartimi i planit vjetor ........ 26
6. Planifikimi i burimeve financiare ........ 27
6.1 Burimet financiare vendore ........ 27
Anekse: ........ 30
- Lista e institucioneve arsimore – ........ 30
- Plani i detajuar i investimeve kapitale – ........ 34
- Rezultatet e konsultimeve publike – ........ 39


REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

# 1. Hyrje dhe konteksti

Plani vjetor i arsimit parauniversitar është një dokument strategjik thelbësor që përcakton objektivat, veprimtaritë dhe masat për organizimin dhe menaxhimin e institucioneve arsimore parauniversitare për fëmijët nga 0 deri në 18 vjeç. Ky plan mbështetet në legjislacionin shqiptar dhe politikat arsimore kombëtare, me qëllim zhvillimin e një sistemi cilësor dhe gjithëpërfshirës të edukimit.

Sistemi arsimor luan një rol kyç në zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit, duke kontribuar në formimin e qytetarëve të përgjegjshëm dhe aktivë. Institucionet arsimore kanë për detyrë tu mundësojnë çdo fëmije arsim gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrje aktive në jetën e komunitetit. Në kuadër të ndarjes së re territoriale, në Bashkinë Pogradec janë 1 çerdhe, 44 kopshte dhe 55 shkolla (arsim bazë+arsim i mesëm)

Menaxhimi sa më efikas i fondeve për arsimin dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore në të gjithë territorin e bashkisë janë prioritete kyçe. Në këtë kontekst, është e domosdoshme të krijohet një mjedis arsimor që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të fëmijëve dhe nxënësve, duke i përgatitur ata për sfidat e së ardhmes.

## 1.1 Profili demografik dhe social i Bashkisë:

**Popullsia:**
Bashkia e Pogradecit shtrihet në juglindje të Shqipërisë, në anë të bregut jugperëndimor të liqenit të Ohrit (695 metra mbi nivelin e detit). Ajo kufizohet në veri me bashkinë e Prrenjasit, në juglindje me bashkinë e Pustecit, në jug me bashkinë e Maliqit dhe në perendim me bashkinë e Gramshit. Sipërfaqja e tij është 548.77 km² dhe ka **90,726 banorë** në përbërjen e territorit. Sipas ndarjes territoriale në të bëjnë pjesë njësitë administrative: Udënisht, Buçimas, Proptisht, Trebinjë, Velçan, Çërravë dhe Dardhas.

**Punësimi dhe Ekonomia:**
Pogradeci ka një ekonomi të orientuar kryesisht nga turizmi, ndërtimi, dhe sektorët e shërbimeve.
Sektorët e tjerë përfshijnë bujqësinë dhe peshkimin.
Popullsia e angazhuar në punë është e ndarë midis punës në qytet dhe migrimit të punëtorëve për punësim sezonin, kryesisht në ndërtim.
Ka gjithashtu një prirje për të angazhuar rininë në punë sezonalë në sektorët e turizmit dhe bujqësisë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

**1.2 Përmbledhje e politikave dhe kuadrit ligjor:**

Plani mbështetet në një kuadër të qartë ligjor dhe rregullator. Dokumentet kryesore përfshijnë:

✓ Ligji Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; i ndryshuar.

✓ Ligji Nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeversisjes Vendore"; i ndryshuar.

✓ Ligji Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar;

✓ Ligji 115/2024, "Për Buxhetin e Vitit 2025"

✓ Ligji Nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Shqipërise", (ndryshuar me ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015, nr. 48/2018, datë 23.7.2018, 44/2023, datë15.6.2023; nr. 99/2012, datë 12.9.2024)

✓ Ligji Nr. 7961 datë. 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

✓ Vendim Nr. 621, datë 22.10.2021 "Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të Planit të Veprimit për Zbatimin e Saj".

✓ Udhëzimi Nr.17 datë 26.07.2023 "Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Udhëzimin Nr. 12, datë 10.06.2021 "Për Procedurat e Pranimit e të Emërimit të Mësuesit në një Vend të Lirë Pune në Institucionet Arsimore Publike të Arsimit Parauniversitar dhe për Administrimin e Portalit "Mësues për Shqipërinë", i Ndryshuar

✓Udhëzim nr. 19, datë 29.08.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 3.5.2024 "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit "Mësues për Shqipërinë", i ndryshuar.

✓Udhëzim nr. 12, datë 24.02.2025 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024, "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë", i ndryshuar"

✓ Udhëzim nr. 21, datë 8.9. 2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për krijimin e klasave të arsimit të orientuar në shkollat e arsimit bazë".

✓ Udhëzim Nr.14 datë 10.07.2023, "Për Numrin e Nxënësve për Klasë dhe Ngarkesën Mësimore të Punonjësve Arsimorë në Institucionet e Arsimit Parauniversitar".

✓ Urdhër Nr. 31, datë 28.1.2020 "Për Miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", (Ndryshuar me Urdhër Nr. 300, Datë 19.6.2024)

✓ Vendim nr. 129, datë 6.3.2024 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 99, datë 27.2.2019, të këshillit të ministrave, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar"

✓ Rregullore Nr.4699/1.Prot, datë 30.04.2019, Për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

## 2. Përmbledhje Ekzekutive

### Misioni dhe vizioni

#### Misioni

Bashkia Pogradec ka si mision të zhvillojë dhe praktikojë politika arsimore përparimtare që sigurojnë kushte optimale për procesin mësimor, përmes një qasje gjithëpërfshirëse për të nxitur socializimin e organizmave të bashkisë dhe te krijojmë mundësi për çdo fëmijë. Angazhimi ynë është të ndërtojmë një mjedis arsimor që promovon kreativitetin, mendimin kritik dhe respektin për diversitetin, duke kontribuar kështu në një të ardhme europiane.

#### Vizioni

Vizioni ynë është të kultivojmë identitetin kombëtar dhe përkatësinë kulturore përmes zhvillimit të aftësive intelektuale, etike, sociale dhe estetike duke besuar se integrimi i teknologjive të reja në procesin mësimor është thelbësor për t'u përshtatur me kërkesat e tregut të punës dhe për të përgatitur nxënësit për sfidat e shekullit XXI, si qytetarë europianë të përgjegjshëm, të cilët të jenë të aftë të përballojnë sfidat e jetës dhe të kontribuojnë në shoqëri

### Qëllimi

***Plani i arsimit parauniversitar ka si qëllim krijimin e një sistemi të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe cilësor për fëmijët dhe të rinjtë nga lindja deri në moshën 18 vjeçare.***

### Synimet e përgjithshme të Planit të Arsimit Parauniversitar

Ky plan synon:

- Të përmirësojë cilësinë e edukimit parauniversitar dhe shërbimeve të çerdhes duke zhvilluar një sistem të qëndrueshëm dhe të aksesueshëm për të gjithë fëmijët dhe nxënësit.
- Të rrisë kapacitetet e mësuesve dhe edukatorëve për të ofruar edukim cilësor duke ofruar një infrastrukturë të sigurt dhe të përshtatshme për të nxitur zhvillimin e fëmijëve.
- Të nxisë pjesëmarrjen e komunitetit dhe prindërve në vendimmarrjet arsimore për perfshirje sociale dhe edukim gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta.
- Të zhvillojë programe trajnuese për mësuesit dhe edukatorët për të përmirësuar praktikat mësimore nëpërmjet përdorimit të teknologjisë në procesin mësimor për të përmirësuar shërbimin mësimor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

## 3. Analiza e shërbimit të Arsimit Parauniversitar

### 3.1 Analiza e struktures (organika)

Qendra Arsimore dhe ZVAP Pogradec përbëhen nga organikat e mëposhtme:

| Qendra Arsimore (6) | Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (9) |
|---|---|
| Drejtori | Drejtori |
| Përgjegjësi i sektorit ekonomik | Specialisti i financës |
| Specialisti i infrastrukturës | Përgjegjësi i sektorit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional |
| Specialisti i financës | Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve |
| Magazinieri | Juristi |
| | Specialistë të zhvillimit profesional |

### 3.2 Situacioni infrastrukturor

Arsimi parauniversitar në Bashkinë Pogradec ka karakteristika:

✓ Kopshte me 2-6 grupe fëmijësh.
✓ Shkolla dhe kopshte me ndërtesa kryesisht 2-3 katëshe.
✓ Infrastruktura e çerdhes dhe kopshteve me ushqim përfshin kuzhinën, dhoma gjumi, ambiente ngrenie dhe ambiente të përshtatshme për mësimdhënie.
✓ Në shumicën e IA ka mungesë së daljeve emergjente.
✓ Shumë pak IA kanë rampa për fëmijët me aftësi të kufizuara.
✓ Ngrohja në IA sigurohet përmes lëndës drusore dhe kaldajave me naftë

✓ Gjendja e godinave aktuale:

| Arsimi parauniversitar | Parashkollor | | Arsimi Bazë | | I mesëm | | Shuma | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Po | Jo | Po | Jo | Po | Jo | Po | Jo |
| Institucione | 44 | | 45 | | 10 | | 99 | |
| Të rikonstruktuar | 0 | 44 | 4 | 41 | 3 | 7 | 7 | 92 |
| Në gjendje të mirë | 42 | 2 | 39 | 6 | 10 | 0 | 91 | 8 |
| Nevojë për rikonstruksion | 2 | | 6 | | 0 | | 8 | |
| Shënime | Nevojë urgjente për rikonstruksion kanë kopshtet në fshatin Remenj dhe Çërravë *Kopshti Udënisht ka | | Nevojë urgjente për rikonstruksion kanë shkollat 9-vjeçare të qytetit, Koli Gusho, Esat Minarolli, Gjokë Shqipatri si edhe shkollat në fshatin Mëmëlisht, Remenj dhe Çërravë. | | Tre gjimnaze janë të rikonstruktuar ndërsa shkollat e tjera janë të gjitha në gjendje të mirë dhe mirëmbahen çdo vit *Shkolla e mesme Udënisht ka | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | nevojë vetëm për rikonstruksion të pjesshëm (ngrohje) | *Shkolla 9-vjeçare Udënisht ka nevojë vetëm për rikonstruksion të pjesshëm (ngrohje) | nevojë vetëm për rikonstruksion të pjesshëm (ngrohje) | |

✓ Numri i godinave ne secilin institucion arsimor është 68, të ndara si më poshtë:

| Përcaktimi | Numri i godinave |
|---|---|
| Çerdhe | 1 godinë |
| Kopshte | 14 godina |
| Shkolla 9- vjeçare + kopshte | 30 godina |
| Shkolla 9-vjeçare + klasë përgatitore | 2 godina |
| Shkolla 9-vjeçare | 11 godina |
| Shkolla të mesme total | 10 godina |
| **Numri total i godinave** | **68 godina** |

### 3.3 Situacioni Mësimor

✓ Arsimi parashkollor, arsimi bazë dhe ai i mesëm në Bashkinë Pogradec zbatojnë kurrikulën kombëtare të bazuar në kompetenca, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Të gjitha institucionet respektojnë strukturën dhe standardet e përcaktuara për çdo nivel arsimor.

✓ Rrjeti Profesional për Arsimin Parauniversitar funksionon rregullisht, në bashkëpunim me ZVA Pogradec dhe DRAP Korçë, duke ofruar trajnim të vazhdueshëm për mësuesit, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

✓ Në çdo Institucion Arsimor janë krijuar dhe funksionojnë normalisht organizmat si, Bordi i kopshtit/shkollës, Këshillat e Prindërve, Komisionet Multidisiplinare, etj.

✓ Procesi mësimor është i ndjekur rregullisht nga nxënësit dhe mësuesit, me shkallë të lartë pjesëmarrjeje. Përmirësimi i metodave të të nxënit, mësimi në bazë projektesh, si dhe vlerësimi formatizues janë integruar gjithnjë e më shumë në praktikat e përditshme.

✓ Fëmijët me aftësi ndryshe janë të përfshirë në institucionet arsimore publike të bashkisë, me mbështetje nga mësues ndihmës dhe specialistë psiko-socialë, në kuadër të përfshirjes dhe barazisë në arsim.

✓ Bashkëpunimi me prindërit është forcuar përmes takimeve periodike, përfshirjes në vendimmarrje dhe pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta. Gjithashtu, shkollat kanë organizuar një sërë aktivitetesh jashtëmësimore me karakter edukativ, patriotik, kulturor dhe sportiv.

✓ Përdorimi i teknologjisë është rritur veçanërisht në shkollat e mesme që përdorin mjete digjitale si projektor, Smart TV, tablet, etj.

### 3.4 Të dhëna për IA,nxënësit, mësuesit dhe drejtuesit në arsimin publik

Bashkia Pogradec mbulon me shërbim institucionet e mëposhtme sipas tabelave statistikore:

| Arsimi parauniversitar | Parashkollor | | Arsimi Bazë | | I mesëm | | Shuma | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | GJ | F | GJ F | Gj F | GJ | F | GJ | F |
| Institucione | 44 | | 45 | | 10 | | 99 | |
| Numri i nxënësve | 1311 | 626 | 4237 | 2069 | 1392 | 684 | 6940 | 3379 |
| Numri i mësuesve | 142 | 142 | 487 | 338 | 125 | 80 | 754 | 560 |
| Nxënës për mësues | 10 | | 9 | | 11 | | 10 | |
| Numri i drejtorëve + nëndrejtorë | 6 | | 31 | | 12 | | 49 | |

### 3.5 Të dhëna për IA,nxënësit, mësuesit dhe drejtuesit në arsimin privat

| Arsimi parauniversitar | Parashkollor | | Arsimi Bazë | | I mesëm i lartë | | Shuma | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gj | F | Gj F | Gj F | Gj | F | Gj | F |
| Institucione | 4 | | 3 | | 2 | | 9 | |
| Numri i nxënësve | 191 | 88 | 556 | 258 | 230 | 123 | 977 | 469 |
| Numri i mësuesve | 13 | 13 | 48 | 41 | 22 | 16 | 83 | 70 |
| Nxënës për mësues | 15 | | 12 | | 11 | | 12 | |
| Numri i drejtorëve | 6 | | | | | | | |

### 3.6 Të dhëna për IA,nxënësit, mësuesit dhe drejtuesit në arsimin profesional

| Arsimi profesional | Parashkollor | |
|---|---|---|
| | Gj | F |
| Institucione | 1 | |
| Numri i nxënësve | 230 | 31 |
| Numri i mësuesve | 21 | 14 |
| Nxënës për mësues | 11 | |
| Numri i drejtorëve | 2 | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

### 3.7 Të dhëna për nxënësit romë dhe egjiptianë në APSH, Arsimin bazë dhe të mesëm

| ROMË | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| GJITHSEJ | | | APSH | | | ARSIMI BAZË | | | ARSIMI I MESËM | | |
| Gjith | F | M | Gjiths | F | M | Gjiths | F | M | Gjith | F | M |
| 53 | 24 | 29 | 7 | 3 | 4 | 35 | 18 | 17 | 11 | 3 | 8 |
| EGJIPTIANË | | | | | | | | | | | |
| GJITHSEJ | | | APSH | | | ARSIMI BAZË | | | ARSIMI I MESËM | | |
| Gjith | F | M | Gj | F | M | Gj | F | M | Gj | F | M |
| 248 | 93 | 155 | 27 | 14 | 13 | 166 | 65 | 101 | 78 | 35 | 43 |

### 3.8 Shërbimi Psiko-Social dhe Nxënësit me Aftësi Ndryshe

Në vitin shkollor 2024-2025, janë identifikuar 140 nxënës me aftësi ndryshe në të gjitha shkollat dhe kopshtet e ZVAP Pogradec. Këta nxënës janë vlerësuar nga një komision multidisiplinar, pasi disponojnë dokumentacionin e nevojshëm dhe kanë bërë kërkesë nga prindërit për mbështetje me mësues ndihmës.

Gjatë kësaj periudhe, numri i mësuesve ndihmës ka qenë 61, me 54 në shkolla dhe 7 në kopshte, duke siguruar një raport prej 1 mësues ndihmës për çdo 2 nxënës me aftësi ndryshe. Nga të evidentuarit, 16 fëmijë kanë frekuentuar kopshtin, 106 nxënës kanë ndjekur shkollën 9-vjeçare, dhe 18 kanë vazhduar në gjimnaz.

Mësuesit ndihmës në Institucionet Arsimore (IA) kanë hartuar dhe zbatuar, në bashkëpunim me shërbimin psiko-social, programin edukativ individual (PEI) për çdo nxënës. Në IA janë të punësuar 2 punonjës socialë që mbulojnë arsimin parashkollor dhe 11 punonjës të shërbimit psiko-social, të cilët mbulojnë 29 institucione arsimore të arsimit parauniversitar.

| FËMIJË/NXËNËS ME AFTËSI NDRYSHE | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| GJITHSEJ | | | APSH | | | ARSIMI BAZË | | | ARSIMI I MESËM | | |
| GJ | F | M | Gj | F | M | Gj | F | M | Gj | F | M |
| **140** | **39** | **101** | 16 | 4 | 12 | 106 | 32 | 74 | 18 | 3 | 15 |

## 4. Objektivat dhe planet e veprimtarive te realizimit te tyre

### 4.1 Objektivat

***1. Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës arsimore në shkolla, kopshte dhe çerdhe, me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kujdesit ndaj fëmijëve.***

**Pritshmëritë:**

- **Ambient i sigurt dhe stimulues**: Krijimi i një ambienti të sigurt dhe stimulues për fëmijët dhe nxënësit do të nxisë zhvillimin kognitiv, social dhe emocional të tyre.
- **Rritja e pjesëmarrjes**: Pritet rritja e numrit të fëmijëve që ndjekin edukimin parashkollor, duke kontribuar në përmirësimin e rezultateve arsimore në të ardhmen.

***2. Ulja e braktisjes shkollore në arsimin e detyruar për vitin shkollor 2024-2025 është 7% të shkojë 4% në arsimin e detyruar për vitin shkollor 2025-2026***

**Pritshmëritë:**

- **Motivim dhe mbështetje**: Një plan i strukturuar do të ndihmojë në motivimin e nxënësve për të vazhduar shkollën, duke ulur shkallën e braktisjes.
- **Pjesëmarrje aktive**: Rritja e angazhimit të prindërve dhe komunitetit në aktivitetet arsimore do të kontribuojë në mbajtjen e nxënësve në sistemin arsimor.

***3. Orientimi drejt Arsimit Profesional duke rritur frekuentimin nga 13% aktualisht, në 20% për vitin e ardhshëm mësimor.***

**Pritshmëritë:**

- **Përgatitja për tregun e punës**: Nxënësit do të pajisen me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të hyrë në tregun e punës ose për të vazhduar arsimin e lartë.
- **Zhvillimi i aftësive praktike**: Ofrimi i mundësive për trajnime dhe praktikë do t'i ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësi që janë të kërkuara nga tregu i punës.
- **Bashkëpunimi** i Bashkisë Pogradec me Ministrinë e Arsimit dhe ZVAP Pogradec

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

**4.2 Masat strategjike (Plani i veprimtarive)**

***<u>Objektivi 1: Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës arsimore në shkolla, kopshte dhe çerdhe, me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kujdesit ndaj fëmijëve.</u>***

Plani i veprimtarive lidhur me zbatimin e objektivave:

| Nr | HARTIMI I OBJEKTIVIT | VEPRIMTARITË | PËRGJEGJËS | AFATI | BUXHETI |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **1.1Ndërtimi i një godine të re për çerdhe (2025-2026)**<br><br>Ky projekt synon ndërtimin e një çerdheje moderne dhe funksionale për fëmijët e moshës 0–3 vjeç, e cila do të plotësojë nevojat gjithnjë në rritje të komunitetit për shërbime cilësore të edukimit të hershëm.<br><br>Çerdhja do të përfshijë ambiente të brendshme të pajisura sipas standardeve bashkëkohore, me dhoma të veçanta për aktivitete, gjumë, ngrënie dhe ambiente higjieno-sanitare.<br><br>Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës arsimore për të siguruar një mjedis të sigurt, funksional dhe gjithëpërfshirës për arsimin dhe kujdesin e hershëm të fëmijëve. | Identifikimi i nevojës për ndërtim duke u bazuar në kërkesat e larta për regjistrimin e fëmijëve Analizë nevojash dhe vlerësim i gjendjes aktuale. | Drejtoria e Urbanistikës, Qendra Arsimore, Bashkia | Mars-Prill 2025 | **30,157,208.61 (fondi i njëjtë me rikonstruksionin e kopshtit "Liri Çomo")** |
| 2 | | Hartimi i një studimi fizibiliteti për të justifikuar ndërhyrjen | Drejtoria e Urbanistikës, Grupi i punës | | |
| | | Konsultimi me komunitetin (prindër, mësues, nxënës, autoritetet lokale) për të përcaktuar prioritetet dhe nevojat. | Qendra Arsimore, Bashki Grupi i punës | | |
| | | Konsultim me Drejtorinë e Urbanistikës për hartimin dhe miratimin e projektit të ndërtimit të çerdhes nga Këshilli Bashkiak | Drejtoria e Urbanistikës, Qendra Arsimore, Bashkia, Këshilli Bashkiak | Prill-Maj 2025 | |
| 3 | | Sigurimi i fondeve nga buxheti qendror/vendor, donator, OJF | Bashkia, MAS, Ministria e ekonomisë, Drejtoria e Financës | Tremujori III-IV 2025 | |
| 4 | | Procesi i prokurimit për ndërtimin e çerdhes (shpallja dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit, fillimi i punimeve dhe mbikqyrja) | Zyra e prokurimeve publike në bashki, Kompania ndërtuese/fituese e tenderit, Inxhinieri i bashkisë | Gusht 2025-Mars 2026 | |
| 5 | | Përfundimi dhe pajisja e çerdhes (inspektimi përfundimtar nga specialistët, pajisja me mobilje, mjete didaktike dhe punësimi i stafit dhe trajnimi i tyre | MAS, QA, Drejtoria e Burimeve Njerzore, Drejtoria e Financës | Tremujori III 2026 | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Të zgjerojmë aksesin në arsim parashkollor, duke ndërtuar një çerdhe që plotëson standardet bashkëkohore për kujdesin ndaj fëmijëve të moshës 0–3 vjeç. | Hapja zyrtare<br>Aktivitet promovues lidhur me fillimin e procesit edukativ për fëmijët (inagurimi i godinës së re)<br>Organizimi i një ceremonie inagurimi, për të rritur transparencën dhe përkrahjen e komunitetit. | Qendra Arsimore, Drejtoria e Burimeve Njerzore, Kryetari i Bashkisë | Shtator 2026 | |

| Nr | HARTIMI I OBJEKTIVAVE | VEPRIMTARITË | PËRGJEGJËS | AFATI | BUXHETI |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **1.2 Rikonstruksioni i kopshtit "Liri Como" (2025-2026)** | Hartimi i projektit teknik për rikonstruksionin e kopshtit Liri Çomo (Angazhimi i grupit të arkitektëve dhe inxhinierëve për përgatitjen e planit të detajuar të rikonstruksionit sipas standarteve për IA Parashkollore si: Hapsira, ndricimi, ngrohja, siguria) | Drejtoria e Urbanistikës, Qendra Arsimore, Bashkia | Tremujori I 2025 | **30,157,208.61 (fondi i njëjtë me ndërtimin e çerdhes)** |
| 2 | | Konsultimi me komunitetin (prindër, mësues, nxënës, autoritetet lokale) për të përcaktuar prioritetet dhe nevojat. | Qendra Arsimore, Komuniteti lokal | Tremujori I 2025 | |
| | | Kërkesën dhe miratimin e buxhetit dhe sigurimi i fondeve nga Ministria e Financës për rikonstruksion (Përcaktimi i kostove dhe miratimi i buxhetit nga Këshilli Bashkiak ose përmes fondeve nga Ministria/ Donatorët) | Drejtoria e Financave, Këshilli Bashkiak, Ministria e Financave | Tremujori II 2025 | |
| 3 | | Prokurimi publik (Përgatitja e dokumentacionit për tender, shpallja e njoftimit në sistem APP dhe ndjekja e procedurave të përzgjedhjes) | Njësia e prokurimit të Bashkisë Pogradec | Korrik-Gusht 2025 | |
| 4 | | Përzgjedhja e subjektit zbatues (Vlerësimi i ofertave dhe nënshkrimi i kontratës me kompaninë ndërtuese fituese) | Komisioni i vlerësimit | Gusht 2025 | |
| 5 | | Fillimi i punimeve/ ndërhyrjeve (çatia, muret, instalimet, fasada, dritare, dysheme, ngrohje, system sigurie, oborr, etj.) | Kompania ndërtuese | Tremujori III 2025 | |
| 6 | | Mbikqyrja dhe raportimi (inspektime nga inxhinieret e bashkisë, përfaqësues nga QA për raportimin e çdo problemi) | Drejtoria e Urbanistikës, Inspektoriati i ndërtimit | Tremujori III 2025 | |

| Nr | HARTIMI I OBJEKTIVAVE | VEPRIMTARITË | PËRGJEGJËS | AFATI | BUXHETI |
|---|---|---|---|---|---|
| 7 | | Dorëzimi i projektit (verifikimi përfundimtar në përputhje me projketin, raportimi teknik, pajisja me mobilje sipas nevojave të ciklit parashkollor dhe pranimi zyrtar i projektit të përfunduar) | Drejtoria e NMIPP, Kompania e ndërtimit, Bashkia, Drejtoria e kopshtit, Drejtoria e Financës | Tremujori I 2026 | |
| 8 | | Rihapja zyrtare e kopshtit (ceremonia simbolike për rihapje të kopshtit me pjesëmarrje të prindërve, fëmijëve, përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe mediave lokale) | Drejtoria e kopshtit, Bashkia, Qendra Arsimore | Tremujori II 2026 | |

| Nr | HARTIMI I OBJEKTIVAVE | VEPRIMTARITË | PËRGJEGJËS | AFATI | BUXHETI |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **1.3 Rikonstruksioni i shkollës "Kajo Karafili" në Gështenjas (brenda 2025)** | Hartimi i projektit teknik për rikonstruksionin e kopshtit Liri Çomo (Angazhimi i grupit të arkitektëve dhe inxhinierëve për përgatitjen e planit të detajuar të rikonstruksionit sipas standarteve për IA Parashkollore si: Hapsira, ndricimi, ngrohja, siguria) | Drejtoria e Urbanistikës, Qendra Arsimore, Bashkia | Janar 2025 | **70,156,980.43** |
| 2 | | Kërkesën dhe miratimin e buxhetit dhe sigurimi i fondeve nga Ministria e Financës për rikonstruksion (Përcaktimi i kostove dhe miratimi i buxhetit nga Këshilli Bashkiak ose përmes fondeve nga Ministria/ Donatorët) | Drejtoria e Financave, Këshilli Bashkiak, Ministria e Financave | Shkurt 2025 | |
| 3 | | Prokurimi publik (Përgatitja e dokumentacionit për tender, shpallja e njoftimit në sistem APP dhe ndjekja e procedurave të përzgjedhjes) | Njësia e prokurimit të Bashkisë Pogradec | Mars 2025 | |
| 4 | | Përzgjedhja e subjektit zbatues (Vlerësimi i ofertave dhe nënshkrimi i kontratës me kompaninë ndërtuese fituese) | Komisioni i vlerësimit | Prill 2025 | |

| Nr | HARTIMI I OBJEKTIVAVE | VEPRIMTARITË | PËRGJEGJËS | AFATI | BUXHETI |
|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Të rrisim cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënit nëpërmjet krijimit të hapësirave të përshtatshme, të sigurta dhe moderne për nxënësit dhe mësuesit. | Fillimi i punimeve/ ndërhyrjeve (çatia, muret, instalimet, fasada, dritare, dysheme, ngrohje, system sigurie, oborr, etj.) | Kompania ndërtuese | Maj 2025 | |
| 6 | | Mbikqyrja dhe raportimi (inspektime nga inxhinieret e bashkisë, përfaqësues nga QA për raportimin e çdo problemi) | Drejtoria e Urbanistikës, Bashkia, Inspektoriati i ndërtimit | Maj-Gusht 2025 | |
| 7 | | Dorëzimi i projektit (verifikimi përfundimtar në përputhje me projketin, raportimi teknik, pajisja me mobilje sipas nevojave të ciklit 9-vjeçar dhe pranimi zyrtar i projektit të përfunduar) | Drejtoria e NMIPP, Kompania e ndërtimit, Bashkia, Drejtoria e kopshtit, Drejtoria e Financës | Gusht 2025 | |
| 8 | | Rihapja zyrtare e shkollës (ceremonia simbolike për rihapje të kopshtit me pjesëmarrje të prindërve, fëmijëve, përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe mediave lokale) | Drejtoria e kopshtit, Bashkia, Qendra Arsimore | Shtator 2025 | |

***Objektivi 2:*** **Ulja e braktisjes shkollore në arsimin e detyruar për vitin shkollor 2024-2025 është 7% të shkojë 4% në arsimin e detyruar për vitin shkollor 2025-2026.**

Braktisja shkollore është një sfidë e rëndësishme për sistemin arsimor, e cila ndikon në zhvillimin e individëve dhe të shoqërisë në tërësi. Objektivi ynë për vitin shkollor 2024-2025 është ulja e shkallës së braktisjes në 7%, me synimin për ta reduktuar më tej në 4% për vitin shkollor 2025-2026.Për të arritur këtë qëllim, ne do të implementojmë një sërë masash të koordinuara që përfshijnë mbështetje për nxënësit në rrezik, angazhimin e prindërve dhe komunitetit, si dhe krijimin e mundësive për aktivitete edukative dhe jashtëshkollore.

Përmes këtyre përpjekjeve, ne synojmë të krijojmë një mjedis arsimor që inkurajon nxënësit të qëndrojnë në shkollë dhe të përfundojnë arsimin e detyruar, duke kontribuar kështu në një të ardhme më të mirë për ta dhe për shoqërinë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

**Objektivi dhe Veprimtaritë**

**Plani i veprimtarive;**

| Nr. | HARTIMI I OBJEKTIVIT | VEPRIMTARITË | PERSONAT PËRGJEGJËS | AFATI | BUXHETI |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Ulja e braktisjes shkollore 7% në 4% për vitin 2025-2026** | Zhvillimi i Sistemit të Parandalimit të Hershëm të Braktisjes Shkollore Identifikimi i nxënësve në rrezik, diskutimi i rasteve, ndërhyrje të koordinuara | Psikologët, NJMF, mësuesit Drejtuesit e IA | 2024-2025 | **11,000,000** |
| 2 | | Trajnimi i mësuesve dhe administrates, zhvillimi i metodave për identifikimin e shenjave të braktisjes | Mësuesit, Administrata | Gjatë vitit shkollor | |
| 3 | | Takime me psikologë dhe prindër, ofrimi i mbështetjes emocionale dhe psikologjike për nxënësit | Psikologët, prindërit, mësuesit | Gjatë vitit shkollor | |
| 4 | | Ndryshimi i metodologjisë së mësimdhënies, trajnime dhe ndarje eksperiencash për mësim më interaktiv | Mësuesit | Gjatë vitit shkollor | |
| 5 | | Aktivitetet me OJF dhe mbështetje financiare, ofrimi i ndihmës për nxënësit në nevojë | Bashkia, OJF, ministritë | Gjatë vitit shkollor | |
| 6 | | Përmirësimi i kushteve të shkollave, sigurimi i infrastrukturës dhe mjedisit të përshtatshëm | Bashkia, institucione arsimore | Gjatë vitit shkollor | |
| 7 | | Mësim individual për nxënësit që hasin vështirësi, ofrohen mundësi për mësim personalizuar | Mësuesit kujdestar | Gjatë vitit shkollor | |
| 8 | | Angazhimi i prindërve në procesin edukativ, organizimi i aktiviteteve për të përfshirë familjen | Prindërit, mësuesit | Gjatë vitit shkollor | |
| 9 | | Aktivitetet jashtëshkollore, ofrimi i mundësive për zhvillim të talenteve | Mësuesit, bashkia | Gjatë vitit shkollor | |
| 10 | | Takime ndërgjegjësimi, organizimi i fushatave për të nxisin vlerën e edukimit | Një grup i punës | Gjatë vitit shkollor | |
| 11 | | Monitorimi dhe mbështetje e vazhdueshme, përdorimi i sistemeve të monitorimit për nxënësit | Psikologët, mësuesit | Gjatë vitit shkollor | |
| 12 | | Vëzhgime dhe analiza, përmirësimi i aktiviteteve bazuar në analizat e bëra | Grupi i punës, NJMF | Gjatë vitit shkollor | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

*(**Sqarim:** Nga analiza e kryer përmes pyetësorëve me të gjithë aktorët e përfshirë, si dhe nga dokumentacionet e organizmave të ndryshëm, rezulton se situata e braktisjes shkollore në Bashkinë Pogradec është shqetësuese. Sipas analizës vjetore të ZVAP Pogradec, Qendrës Arsimore Pogradec dhe shërbimeve të psikologëve, ka një numër të konsiderueshëm fëmijësh që rrezikojnë të braktisin shkollën. Kjo situatë kërkon një vëmendje të veçantë, pasi braktisja shkollore jo vetëm që ndikon në zhvillimin e individëve, por gjithashtu ka pasoja negative për shoqërinë në tërësi. Identifikimi i këtyre fëmijëve dhe ofrimi i mbështetjes së nevojshme është thelbësor për të siguruar që ata të kenë mundësi për një arsimim të qëndrueshëm dhe të suksesshëm. Prandaj, është e domosdoshme që të mobilizojmë të gjithë aktorët, përfshirë prindërit, mësuesit, psikologët dhe organizatat lokale, për të krijuar një sistem mbështetës që ndihmon në parandalimin e braktisjes dhe promovon një mjedis arsimor pozitiv dhe inkurajues për të gjithë fëmijët në Bashkinë Pogradec.)*

***Objektivi 3:* Orientimi drejt Arsimit Profesional duke rritur frekuentimin nga 13% aktualisht, në 20% për vitin e ardhshëm mësimor.**

**Rëndësia e Arsimit Profesional**

Arsimi profesional luan një rol kyç në zhvillimin e individëve dhe shoqërisë në tërësi. Ai ofron një rrugë alternative për nxënësit, duke i pajisur ata me njohuri praktike dhe aftësi të specializuara që janë thelbësore për integrimin e tyre në tregun e punës. Në një botë që po ndryshon me shpejtësi, ku kërkesat për aftësi të reja janë në rritje, arsimi profesional ofron mundësi që përfshijnë jo vetëm formimin teknologjik, por edhe zhvillimin e aftësive ndërpersonale dhe menaxheriale. Arsimi profesional është një element thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë në të gjithë vendin. Ai ndihmon rininë të zhvillojë aftësi të nevojshme për tregun e punës dhe kontribuon në rritjen e ekonomisë lokale, duke ruajtur njëkohësisht traditat kulturore.

Mbështetje të fortë për këtë proces ofrojnë jo vetëm mësuesit koordinatorë të këshillimit të karrierës, të cilët luajnë një rol kyç në orientimin e nxënësve, por gjithashtu edhe institucione të tjera shtetërore si Bashkia, Ministria e Arsimit etj. Këto struktura janë të përgjegjshme për krijimin e një ambienti arsimor që promovon zhvillimin profesional dhe ndihmon në krijimin e mundësive për praktikë dhe angazhim në projekte komunitare.

Bashkëpunimi mes të gjithë aktorëve është thelbësor për të siguruar që rinia e qytetit të Pogradecit të ketë akses në mundësi të shumta që do t'i ndihmojnë ata të zbulojnë dhe realizojnë potencialin e tyre. Kjo përfshin zhvillimin e programeve që lidhen me nevojat e tregut të punës dhe mbështetje për aktivitete që nxisin kreativitetin dhe inovacionin.

Arsimi Profesional është një investim në të ardhmen e shoqërisë, duke siguruar që të rinjtë të jenë të përgatitur për sfidat e një bote gjithnjë në ndryshim.

**Rëndësia e Arsimit Profesional në Pogradec**

Në kontekstin e qytetit të Pogradecit, ku traditat kulturore dhe peizazhi natyror ofrojnë mundësi unike, arsimi profesional merr një dimension të veçantë. Ky qytet, me potencialin e tij për zhvillim turistik dhe ekonomik, kërkon një forcë punëtore të kualifikuar dhe të përgatitur për sfidat e tregut të punës. Arsimi profesional ndihmon në përgatitjen e rinisë për të kontribuar në ekonomi lokale, duke nxitur zhvillimin e aftësive që lidhen me turizmin, artizanatin dhe shërbimet.

Me këtë në mendje, roli i mësuesve si koordinatorë të këshillimit të karrierës bëhet gjithashtu jetik. Mësuesit e këtij profili Duke krijuar një lidhje të ngushtë me industrinë dhe komunitetin, këta mësues mund të ofrojnë informacion të vlefshëm mbi tendencat e tregut të punës dhe mundësitë për praktikë, duke i ndihmuar nxënësit të bëjnë zgjedhje të informuara.

**Aktivitetet për Orientimin drejt Arsimit Profesional**

*Pogradeci, me peizazhet e tij të bukura dhe traditat kulturore, ofron mundësi të shkëlqyera për aktivitete inovative që lidhen me orientimin drejt arsimit profesional.*

**1. Programi "Mentorimi për Traditat Lokale"**

- Krijimi i një programi ku profesionistët e artizanatit dhe traditave lokale, si punimi i drurit, qeramika, dhe tekstili, etj, ofrojnë mentorim për nxënësit. Ky program do të ndihmojë në ruajtjen e traditave kulturore dhe do të inkurajojë nxënësit të zhvillojnë aftësi praktike.
- **Aktiviteti:**
  - Organizimi i sesioneve praktike ku nxënësit do të mësojnë teknika tradicionale nga mjeshtra lokalë. Këto mund të përfshijnë punimin e objekteve dekorative, mobiljeve, ose veshjeve tradicionale.
  - Nxënësit do të krijojnë produkte që mund të shiten në tregun lokal, si suvenire apo artikuj për dekorim. Kjo do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive të biznesit dhe të marketingut.
  - Organizimi një ekspozitë për të promovuar produktet e krijuara nga nxënësit, duke i dhënë mundësi atyre të prezantojnë punën e tyre dhe të angazhohen me komunitetin.

**2. Kampusi i Inovacionit në Pogradec**

- Krijimi i një "kampusi inovacioni" ku nxënësit mund të punojnë në projekte praktike që lidhen me nevojat e komunitetit. Ky kampus do të funksionojë si një hapësirë bashkëpunimi dhe krijimi.

- **Aktiviteti:**
  - Për Degën e Hotelëri dhe Turizëm: Krijimin e një programi turistik që promovon mbrojtjen e liqenit dhe aktivitete të qëndrueshme për turistët, si ekskursione për pastrimin e bregut.
  - Për Degën e Inxhinieri Elektrike: Zhvillimin e një sistemi solar për ndriçimin e hapësirave publike pranë liqenit, duke reduktuar ndotjen dhe promovuar energjinë të qëndrueshme.
  - Për Degën e Inxhinieri Mekanike: Krijimin e një sistemi riciklimi për mbeturinat në komunitet, duke përdorur teknologji të avancuara për menaxhimin e mbetjeve.

**3. Programet e Shërbimit në Komunitet**

- Krijimi i mundësive për nxënësit të angazhohen në shërbime komunitarë, si ndihma në organizimin e aktiviteteve kulturore dhe ndihma për ata që kanë nevojë.
- **Aktiviteti:**
  - Organizimi i një eventi gastronomik: Nxënësit përgatitin receta tradicionale dhe shërbejnë ushqimin për komunitetin.
  - Krijimi i pakove turistike: Nxënësit zhvillojnë paketa turistike për vizitorët që përfshijnë aktivitete kulturore dhe natyrore në zonë.
  - Workshop mbi sigurinë elektrike: Nxënësit mësojnë rreth praktikave të sigurta në instalimet elektrike dhe riparimet.

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA POGRADEC

- Konkurs për dizajnin e një pajisjeje elektronike: Nxënësit konkurrojnë për të krijuar pajisje që zgjidhin probleme të përditshme.
- Workshop për teknikat e saldimit dhe ndërtimit: Nxënësit mësojnë teknika praktike për saldimin dhe ndërtimin e strukturave.

**Plani i veprimtarive;**

| NR | HARTIMI I OBJEKTIVIT | VEPRIMTARITË | PËRGJEGJËSIT | AFATI | BUXHETI |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Orientimi drejt Arsimit Profesional duke rritur frekuentimin nga 13% aktualisht, në 20% për vitin e ardhshëm mësimor.** | Organizimi i sesioneve praktike ku nxënësit do të mësojnë teknika tradicionale nga mjeshtra lokalë. Këto mund të përfshijnë punimin e objekteve dekorative, mobiljeve, ose veshjeve tradicionale.<br><br>Organizimi i ditëve të hapura në shkollat profesionale dhe prezantimi i historive të suksesit të ish-nxënësve të arsimit profesional që janë bërë sipërmarrës apo janë punësuar menjëherë pas shkollës. Nxënësit do të krijojnë produkte që mund të shiten në tregun lokal, si suvenire apo artikuj për dekorim. Kjo do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive të biznesit dhe të marketingut.<br><br>Zhvillimi i sesioneve të këshillimit profesional që në ciklin 9-vjeçar, për t'i ndihmuar nxënësit të zbulojnë aftësitë dhe interesat e tyre, duke angazhuar psikologë shkollorë dhe kordinatorët e karrierës për të ofruar informacion dhe udhëzim.<br><br>Organizimi i panaireve të karrierës ku nxënësit të takohen me përfaqësues të bizneseve dhe kompanive.<br>Krijimi i praktikave profesionale dhe intershipeve për nxënësit. | Mësues, Artizanë lokalë | **2025-2026** | **14,954,760** |

REPUBLIKA E SHQIPERISË ... POGRADEC

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Organizimi një ekspozitë për të promovuar produktet e krijuara nga nxënësit, duke i dhënë mundësi atyre të prezantojnë punën e tyre dhe të angazhohen me komunitetin. | | | | |
